

EDMOND ÇALI

**ZHVILLIMET GJUHËSORE NGA VARIANTET E AUTORIT
NË VEPRËN E ISMAIL KADARESE DASHA 1968
DHE LËKURA E DAULLES 1980**

1] Romani *Dasha* është një nga veprat më të rëndësishme në prozë të Ismail Kadarese. Vendi që zë romani në sistemin letrar të autorit rrjedh nga lidhjet e tij me veprat *Dimri i vetmisë së madhe*, *Ura me tri harqe* dhe *Prilli i thyer*. Ka rëndësi edhe për shqyrtimin e lidhjes dhe të vendosjes së gjithë veprës së autorit në sistemin letrar shqiptar dhe në sistemin e letërsisë shqipe të realizmit socialist. Botimet e shumta të veprës e vendosin pranë veprave të tjera që gjatë viteve u janë nënshtruar në botimet e tyre ripunimeve të autorit. Ky roman është një roman-laborator për krijimtarinë e Kadarese qoftë për temat, qoftë për gjuhën e autorit dhe për zhvillimet e saj në ripunimin e tekstit.

Në këtë punim shqyrtojmë zhvillimet gjuhësore që na rezultojnë nga studimi i varianteve të autorit në dy botime të romanit: në botimin e vitit 1968 dhe në botimin e vitit 1980. Botimi i vitit 1968 është botimi i parë si vëllim më vete në Tiranë. Botimi i parë si libër më vete ishte bërë në Prishtinë që në vitin 1967 menjëherë pas botimit në revistën *Nëntori*. Botimi i vitit 1968 ka titullin *Dasha* dhe ka 23 kapituj të pajisur me titull. Në vitin 1980 Ismail Kadare e boton romanin me titullin “Lëkura e daulles” në vëllimin *Gjakftohësia* (f. 361-485)¹. Titullin e kemi me shkrim të pjerrët në fund të faqes 361 të vëllimit. Nuk kemi saktësimin e gjinisë së këtij shkrimi në veçanti, por përcaktimin e kemi që në f. 1, ku poshtë titullit *Gjakftohësia* kemi përcaktimin me shkronja të mëdha “Novela”. Pra kemi një ndryshim në përcaktimin e gjinisë së veprës. Në botimin e vitit 1968 përcaktimi “Roman” jepet me shkronja të mëdha që në kapakun e librit, sipër në të djathtë të titullit. Përcaktimi jepet gjithashtu edhe në f. 1, që është ballina e librit, ku përcaktimi “Roman”, i shkruar me shkronja të mëdha është vendosur poshtë titullit në qendër të faqes. Kalojmë nga 20.000 kopjet e tirazhit të botimit të vitit 1968 në 25.000 kopjet e vëllimit *Gjakftohësia*².

¹ Në vëllim kemi edhe pjesën “Gjakftohësia” (f. 3-48) të marrë nga *Koncert në fund të dimrit*, “Kush e solli Doruntinën” (ff. 49-178), “Prilli i thyer” (179-360) dhe “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” (f. 487-541).

² Botimet e romanit janë këto: I. Kadare, *Dasha*, në “Nëntori”, 1967/8, ff. 3-104 – botimi i parë; I. Kadare, *Dasha*, Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë, 1968, f. 224 – botimi i dytë; I. Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Gjakftohësia”, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 361-485 – botimi i tretë; I. Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Vepra”, vëllimi i nëntë, Shtëpia botuese Fayard, 2000, f. 19-128 – botimi i katërt; I. Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Vepra. Vëllimi i katërt”, Onufri, Tiranë, 2008, f. 495, f. 357-494 – botimi i pestë; në rastet e tjera kemi të bëjmë me rishtypje të romanit.

2] a. Siç e shohim kemi edhe ndryshimin e titullit të veprës. Edhe kapitujt që ishin të pajisur me titull në *Dasma*, në *Lëkura e daulles* nuk kanë më titull por janë të pajisur me numër me shifër romake.

Kemi ndryshime strukturore e përmbajtësore. Kalohet nga 23 kapitujt e *Dasmës* në 20 kapitujt e *Lëkurës së daulles*. Pra kemi eliminimin e tre kapitujve. Por kemi edhe eliminime të tjera në tekst. Gjithsej në kalimin nga *Dasma* 1968 në *Lëkura e daulles* 1980 eliminohen 1452 rreshta. Po të kemi parasysh që një faqe e botimit të vitit 1968 ka 30 rreshta, na del se eliminohen 48 faqe e gjysmë. Shtohen gjithsej vetëm 25 rreshta, pra as edhe një faqe e plotë.

Eliminimet e tre kapitujve kanë rëndësi për strukturën rrëfimtare sepse rrëfimi cungohet nga një pjesë e mirë e tij nga pikëvështrimi i Xhevitit dhe i Katrinës (Eliminohen kapitujt “Xheviti”, f. 51-53, “Katrina”, f. 76-88 dhe “Xheviti”, f. 131-143). Pra, ky eliminim ka rëndësi përmbajtësore por edhe strukturore sepse në rrëfim pas eliminimit mungon pikëvështrimi i Xhevitit dhe i Katrinës. Eliminimi i pjesëve të tjera ka rëndësi edhe sepse varfëron rrëfimin, edhe pse dobëson lidhjet strukturore të romanit me veprat të tjera të Kadaresë. Një eliminim shumë i rëndësishëm është ai i kapitullit “Nata e betonimit dhe nata e Bartolomeut” të *Dasmës* që është kapitulli VIII *Lëkurës së daulles*. Kemi bisedën e shkrimtarit me vajzën që njeh në dasëm për fenë³. Flitet për natën e Shën Bartolomeut. Është një ngjarje shumë e rëndësishme në jetën e Krishtërit. Është një larje hesapesh. Është një paralelizëm me periudhën e kohës së historisë së romanit në të cilën po laheshin hesapet edhe brenda komunizmit. Po laheshin hesapet midis shteteve komuniste dhe midis komunizmit dhe Krishtërit. Kujtimi i natës midis 23 dhe 24 gushtit të vitit 1572, kur u vranë me mijëra të krishterë në Paris dhe në provincën rreth tij, vrasja me urdhërin e Karlit IX e mijëra protestantëve, masakra a Shën Bartolomeut, vrasja masive e Shën Bartolomeut u vendoset afër ngjarjeve të Shqipërisë së kohës ku “feja e re”, komunizmi po shfaroste çdo besim fetar.

Një eliminim tjetër shumë i rëndësishëm është ai i kapitullit “*Dasma vazhdon*” të *Dasmës*, që është kapitulli X i *Lëkurës së daulles*: ka të bëjë me personazhin e Rudit dhe të djemve të rrugës së Dibrës që e lidh romanin me librin *Dimrit të vetmisë së madhe*. Eliminohet intertekstualiteti. Eliminimi i kësaj pjese e dëmton romanin edhe para syve të asaj pjese të kritikës që e vlerëson atë si një vepër të dobët. Edhe pse sipas nesh ky vlerësim negativ për romanin lidhet vetëm

³ Shih E. Çali, *Feja dhe variantet e autorit në romanin “Dasma” të Ismail Kadaresë*, në “Materiallet e punimeve të Seminarit XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, Prishtinë, 17-28.08.2015, 34/2”, Prishtinë, 2015, f. 191-206. Për romanin *Dasma* shih edhe: E. Çali, *Letërsia dhe feja (Tre autorë të realizmit socialist shqiptar: Jakov Xoxa, Ismail Kadare dhe Skënder Drini)*, në “Jeta e re”, Prishtinë, 2014/2, ff. 291-322; E. Çali, *Vështrim variantistik romanit “Dasma” të Ismail Kadaresë*, SF, 2013/1-2, ff. 179-202; E. Çali, *Kode të mëdha në vepra (të mëdha dhe) të vogla (E. Koliqi-“Gjaku”, I. Kadare-“Dasma”, S. Drini-“Shembja e idhujve” & “Midis dy kohëve”, E. Dones-“Vergine giurata/Hana”)*, në “Materiallet e punimeve të Seminarit XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 18-30.08.2014, 33/2”, Prishtinë, 2015, f. 125-142.

me përkatësinë e tij rrymës letrare të realizmit socialist, dobësimi i lidhjes me romanin e madh historik dhe me gjithë pjesën tjetër të sistemit të veprës së Kadaresë ndihmon abuzimin për lënien mënjane të veprës. Një ndryshim tjetër përmbajtësor me rëndësi është ndryshimi i emrit të njërit prej personazheve kryesore, të shkrimtarit, emri i të cilit jepet vetëm më inicialet e emrit dhe të mbiemrit.

b. Ja si na del ndryshimi i emrit të përveçëm. Në çdo çift forma e parë është e *Lëkurës së daulles* 1980 dhe forma i dytë pas kllapës katrore është ajo e *Dasmës* 1968: 372 *së punëtorëve të Vlorës,*] *së punëtorëve të Ilaçit*, 18; 372 –*Të ftuarit e Shkodrës!*] – *Azoteci!* 18; 393 – *Të ftuarit e Shkodrës!*] – *Azoteci!* 45; 372 *të ftuarit e Shkodrës.*] *montatorët e Azotecit*. 18; 393 *e pleqve të Korçës]* *e pleqve të Lapardhasë* 46;395 *Pranvera.*] *vajza*. 49;428 –*Rolin e presidentit të Shteteve të Bashkuara*] –*Rolin e Xhonsonit* 121; 475 *e Hrushovit.*] *e njeriut që të bën gjëmën*. 212; 477 *ai.*] S.K. 215 - Inicialet e emrit zëvendësohen me përemrin vector, veta e tretë, numri njëjës, rasa emërore

Ja si na del ndryshimi i emrit të përveçëm të shkrimtarit. Në çdo çift forma e parë është e *Lëkurës së daulles* 1980 dhe forma i dytë pas kllapës katrore është ai i *Dasmës* 1968:

371 - *vazhdoi D.D.*] – *vazhdoi S.K.* 16; 375 *tha D.D.*] *tha S.K.* 23; 376 *D.D. u afrua*] *S.K. u afrua* 24; 370, 373, 390, 393 *shkrimtarit D.D.*] *shkrimtarit S.K.* 14, 19, 41, 46;⁴

3] Ndryshimet gjuhësore janë fonetike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore. Nëse disa nga ndryshimet sintaksore do të mund të futeshin në përpunimin e stilit të autorit, ndryshimet fonetike, morfologjike dhe, deri diku edhe ato leksikore, duhen interpretuar në kuadrin e kalimit nga gjuha e vitit 1967 në gjuhën e vitit 1980, para dhe pas Kongresit të drejtshkrimt.

1. Ndryshimet fonetike

1) zëvendësimi i bashkëtingëllores mbylltore qiellzore të pazëshme *q* me bashkëtingëlloren mbylltore grykore të pazëshme *k*:

364 *Një makinist*] *Një maqinist* 5; 484 *ky makinist*] *ky maqinist* 223; 395 *makinistë,*] *maqinistë*, 49;401, 484, 485 *makinistët*] *maqinistët* 60, 223, 224; 392 *makina (emër, numri shumës, trajta e pashquar, rasa emërore)]* *maqina* 44; 412 *me makinat*] *me maqinat* 91; 476 *të një makine.*] *të një maqine* 214

2) zëvendësimi i bashkëtingëllores fërkimore alveolare të zëshme *z* me bashkëtingëlloren fërkimore alveolare të pazëshme *s*: 366 *me qiparisa*] *me qipariza* 8; 381 *Gjithë mëngjesin*] *Gjithë mëngjezin*, 30; 476 *të mëngjesit*] *të mëngjezit* 214

3) zëvendësimi i bashkëtingëllores mbylltore grykore të zëshme *g* me bashkëtingëlloren mbylltore grykore të pazëshme *k*: 366 *nuk ekziston*] *nuk egziston* 8; (por edhe: 366 *nuk ekzistonte*] *nuk ekzistonte* 8)

4) zëvendësimi i zanores *ë* me zanoren *u*: 370 *për shembull*] *për shembëll* 14

⁴ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

Kemi oscilacion në përdorimin e formës së të njëjtës fjalë sepse kemi edhe mbetjen e së njëjtës formë: 392 *Për shembull,*] *Për shembull* 43

5) Dhe zëvendësimin e zanores *ë* me zanoren *e*: 414 *Për shembull,*] *Për shëmbull* 97; 477 – *Po lozin menç,*] – *Po lozin mënç*, 215

(Ndoshta kemi një korrigjim të një gabimi shtypi: 415 *shënoi:*] *shenoi:* 97)

6) Përdorimi i zanores *ë*:

- bie zanorja *ë* dhe kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës:

373 *breshri.*] *breshëri.* 19; 467 *breshrin*] *breshërin* 198

- kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës:

374 *dhëndri?*] *dhëndëri?* 20; 377, 390, 408, 459 *dhëndri*] *dhëndëri* 25, 41, 73, 188; 378 *i dhëndrit?*] *i dhëndërit?* 26; 418 *bashkë me dhëndrin*] *bashkë me dhëndërrin* 105; 428 *dhëndrin*] *dhëndërrin* 120; 458 *e dhëndrit*] *e dhëndërrit* 186

- kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës: 433 *Më dhemb koka*] *Më dhëmb koka* 144

- kemi uniformim pasi kishte oscilacion: 459 *nga dhembja*] *nga dhimbja* 187: këtu kalohet nga një formë e normës në një formë tjetër të normës

480 (*ndjeu*) *një dhembje*] *një dhëmbje* 219: këtu kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës

7) Zëvendësimi i bashkëtingëllores dridhëse qiellzore-alveolare *rr* me bashkëtingëlloren dridhëse alveolare *r*. Kalohet kështu nga një formë jo e normës në formën e normës:

376 *me kureshtje*] *me kureshtje* 23; 408 *me kureshtje.*] *me kureshtje.* 72; 447 *kureshtare*] *kureshtare* 173; 440 *gjashtë e çerek,*] *gjashtë e çerrek*, 161

8) Zëvendësimi i bashkëtingëllores dridhëse alveolare *r* me bashkëtingëlloren dridhëse qiellzore-alveolare *rr*. Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës:

391 *me korrespondentin*] *me korespondentin* 43; 423 *një korrespondent*] *një korespondent* 116; 454 *korrespondenti*] *korespondenti* 181; 454 *korrespondenti*] *korespondenti!* 181; (por edhe 391 *korrespondenti,*] *korrespondenti,* 43); 402, 403 *në korridorin*] *në koridorin* 62, 63; 402 *në korridor,*] *në koridor*, 62; 403 *Në korridor*] *Në koridor* 63; 435 *korrierët,*] *korierët*, 146; 392 *korrigjonin*] *korigjonin* 43

9) Zëvendësimi i zanores *e* me zanoren *ë* dhe kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës: 380, 469 *atëherë,*] *atëhere* 29, 201; 459 *Atëherë*] *Atëhere*, 187; 473 *Qysh atëherë*] *Qysh atëhere*, 207; 482 *Atëherë,*] *Atëhere*, 221

10) Zëvendësimi i zanores *u* me zanoren *ë*. Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës:

382 *një ulërimë!*] *një ulurimë!* 32; 416 *ulërima*] *ulurima* 99; (por edhe: 383 *ulërimat*] *ulërimat* 32); 383 *ulërinin*] *ulurinin* 32; 405 *ulërijnë*] *ulurijnë* 66;

11) Shtohet zanorja *ë* dhe kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës: 383 *gjakësi*] *gjaksi* 33; 385 *i gjakësit*] *i gjaksit* 35; 416 *së gjakësit,*] *së gjaksit*, 99

12) Zëvendësimi i bashkëtingëllores mbylltore dhëmbore të zëshme *d* me bashkëtingëlloren mbylltore dhëmbore të pazëshme *t*. Kalohet nga një formë jo e

normës në formën e normës: 416 *përpara rafteve gjigante]* *përpara rafteve gjigande* 98; 416 *gjigant]* *gjigand* 98

2. Ndryshimet morfologjike

2.a. folja

Ndryshon forma e foljes *jam* në vetën e tretë, numri njëjës, koha e pakryer, mënyra dëftore. Kalohet nga forma *ish* në formën *ishte*. Të dyja janë forma të normës.

366 *ishte një emër]* *ish një emër* 7; 367 *ishte akoma pa emër]* *ish akoma pa emër* 10; 382, 412 *ishte]* *ish* 32, 90; (456 *Ky ishte]* *KY ISHTE* 184: kemi oscilacion, kishim të njëjtën formë që mbetet); 376 *Ai ishte]* *Ai ish* 24; 381 *ishte e tërthortë]* *ish e tërthortë* 30

Ky ndryshim pasqyrohet automatikisht edhe në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore që rezulton nga koha e pakryer e foljes *jam* plus pjesoren e foljes: 408 *ishte ulur]* *ish ulur* 73; 375 *ishte afruar]* *ish afruar* 22; 376 *Plaku ishte lagur]* *Plaku ish lagur* 24; 381 *ishte ngritur]* *ish / ngritur* 30/31; 386 *Ishte bërë]* *Ish bërë* 37; 463 *ishte përhapur]* *ish përhapur* 193

Autori ndryshon formën e foljes *kam* në vetën e tretë, numri njëjës, mënyra dëftore, koha e pakryer nga *kish* në *kishte*. Të dyja format janë forma të normës.

377 *Ajo kishte]* *Ajo kish* 25; 382 *mendjen e kishte]* *mendjen e kish* 32; 406, 466 *kishte]* *kish* 66, 198; (Por edhe: 481 *Kishte]* *KISHTE* 220 dhe kështu mbetet e njëjta formë)

Në formën mohore: 408 *nuk e kishte mendjen.] nuk e kish mendjen.* 73; 469 *S'kishte]* *Nuk kish* 201; 367 *s'kishte si të ndodhte ndryshe]* *s'kish si të ndodhte ndryshe* 10; 366 *nuk kishte asnjë fshat]* *nuk kish asnjë fshat* 7

Ky ndryshim pasqyrohet automatikisht edhe në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore që rezulton nga koha e pakryer e foljes *kam* plus pjesoren e foljes.

364 *kishte telefonuar]* *kish telefonuar* 5; 364 *kishte lajmëruar]* *kish lajmëruar* 5; 364 *kishte thënë]* *kish thënë* 5; 364, 412 *kishte dëgjuar]* *kish dëgjuar* 5, 91; 386 *Ai kishte dëgjuar]* *Ai kish dëgjuar* 37; 366 *kishte ndodhur]* *kish ndodhur* 8;

366 *kishte ndier]* *kish ndjerë* 8 ndryshon, përveç formës së foljes *kam*, edhe forma e pjesores së foljes ndjej. 367, 381 *kishte mbetur]* *kish mbetur* 9, 31;⁵

Ndryshon koha e foljes: kalohet nga koha e tashme në kohën e pakryer të mënyrës dëftore:

364, 397 *me sa dukej]* *me sa duket* 6, 54; 365 *siç dukej]* *siç duket* 7; 467 *ishte Rozafa]* *është Rozafa* 198; 467 *zgjateshin e zgjateshin]* *zgjaten e zgjaten* 198; 467 *Ata shtriheshin]* *Ata shtrihen* 198; 467 *po jepte shpirt]* *po jep shpirt* 198; 467 *kërkonte]* *kërkon* 198; 467 *kishte uri.] ka uri.* 198; 467 *ishte e dobët,]* *është e dobët,* 198; 467 *dëgjonte]* *dëgjon* 198

Ndryshon koha e foljes: kalohet nga koha e tashme në kohën e pakryer të mënyrës lidhore:

407 *të fliste]* *të flasë* 71; 445 *të buzëqeshte.] të buzëqeshë.* 166

⁵ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

Ndryshon koha e foljes që është pjesa e dytë e kallëzuesit të përbërë foljor, kalohet nga koha e tashme në kohën e pakryer të mënyrës lidhore: *387 nisi të qante] nisi të qajë 38;387 filloi të ronitej.] filloi të ronitet 38; 452 Pastaj filluan të zbardheshin.] Pastaj filluan të zbardhen. 179;454 ata filluan të na silleshin ftohtë,] ata filluan të na sillen ftohtë, 180;464 ai filloi të lëvizte] ai filloi të lëvizë 194;472 filluan të pëshpëritnin] filluan të pëshpërisin 205;472 Ato filluan të grindeshin] Ata filluan të grinden 206; 478 vazhdoi të vështronte] vazhdoi të vështrojë 216*

Ndryshon koha e foljes: kalohet nga koha e kryer e thjeshtë në kohën e kryer të mënyrës dëftore

470 ka mbaruar] mbaroi 202

Ndryshon mënyra dhe koha e foljes: kalohet nga koha e ardhshme e mënyrës dëftore në kohën e tashme të mënyrës kushtore: *467 do ta muronin] do ta murojnë 198*

Ndryshon mënyra e foljes: kalohet nga mënyra përcjellore në mënyrën dëftore: *475 Ndërsa vallëzonte.] Duke kërcyer, 212*

Ndryshon forma e kohës së kryer të thjeshtë të foljes, kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës: *364 u mor vesh] u muar vesh 6 kemi kalimin nga një formë jo e normës në formën e normës të së kryerës së thjeshtë, veta e tretë, numri njëjës, të foljes marr.*

372 dole] dolle 19 kalohet nga një formë jo e normës e foljes në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore në formën e normës; 401, 450, 455, 471, 477 u përgjigj] u përgjegj 60, 175, 183, 205, 215;413 nuk u përgjigj.] nuk u përgjegj 93;465 Ai nuk u përgjigj.] Ai nuk u përgjegj. 197;477 Ai nuk u përgjigj.] Ai nuk u përgjegj, 215

Ndryshon forma e pjesores në formën e pashtjelluar të foljes pa+pjesore: *434 pa u përgjigjur.] pa u përgjegjur. 145*

Ndryshon forma e foljes në vetën e tretë numri njëjës, koha e pakryer, mënyra lidhore. Nga oshilacioni që kishte në përdorim kalohet në formën e normës: *445 desha t'i thosha] desha t'i thoshja 165;459 t'u thosha:] t'u thoja: 188*

Kemi oscilacion në përdorimin e foljes në kohën e pakryer, mënyra dëftore: *453 thoshin.] thonin. 180; (Mbetet përdorimi i formës së normës: 454 thoshin] thoshin 181)*

Ndryshon forma e vetës së dytë, numri shumës, koha e tashme, mënyra dëftore, e foljes kam:

395 Nuk keni] Nuk kini 49;402 e keni fjalën.] e kini fjalën? 62;435 S'keni] S'kini 146

Ky ndryshim rezulton automatikisht edhe në kohën e kryer të foljes që formohet nga koha e tashme e foljes kam plus pjesoren e foljes: *373 keni ardhur] kini ardhur 19*

Në përdorimin e foljes *ndiej/ndjeva/ndier* kalohet nga forma jo të normës në forma të normës:

- në kohën e tashme të mënyrës dëftore: 374 –*A nuk e ndien*] –*A nuk e ndjen* 21; 477 – *E ndien?*] – *E ndjen?* 216;407 *ndiej*] *ndjej* 71;470 (*unë ndiej*] *ndjej* 202;473 *Unë e ndiej*] *Unë e ndjej* 207;467 *ti e ndien*] *ti e ndjen* 199

- në kohën e pakryer të mënyrës dëftore: 387 *E ndiente veten*] *E ndjente veten* 38; 465 *ndiente (ai)*] *ndjente* 197;452 *ndienin*] *ndjenin* 179;471 *unë ndieja*] *unë ndjeja* 204

Ndryshon pjesorja e foljes *ndiej/ndjeva/ndier*. Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës: 382 *kishte ndier*] *kish ndjerë* 31;382 *Ai nuk e kishte ndier*] *Ai nuk e kish ndjerë* 32;375 *pa u ndier*] *pa u ndjerë* 22

Ndryshojnë format e foljes *parandiej/parandjeva/parandier*. Kalohet nga format jo të normës në format e normës të kohës së tashme të mënyrës dëftore: 375 –*Parandiej diçka të keqe*] – *Parandiej diçka të keqe* 22;375 – *Parandiej diçka.*] – *Parandiej diçka.* 22;382 *parandien.*] *parandjenë* 32

Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës së foljes vë, në vetën e tretë, numri njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore: 375 *vë*] *ve* 22

Në përdorimin e foljes *hipi/hipa/hipur* kalohet nga format jo të normës në formën e normës. Zëvendësohet zanorja *y* me zanoren *i* në temën e foljes:

- tek pjesorja e foljes: 380, 382 *duke hipur*] *duke hypur* 29, 31;457 *kish hipur*] *kish hypur* 185;476 *të kenë hipur*] *të kenë hypur* 213

- në format e kohës së kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore: 400 – *Hipi*] – *Hypi* 60; 405 *hipëm*] *hypëm* 66;446 *se ne na hipi në kokë.*] *se gjaku ne na hypi gjaku në kokë.* 168

- në të pakryerën e lidhore: 476 *ata mund të hipin*] *ata mund të hypin* 213

- në të pakryerën e dëftore: 484 *hipnin*] *hypnin* 224

I njëjti ndryshim ndodh edhe në mbiemrin e nyjshëm prejfoljor: 451 *të hipura*] *të hypura* 177

Ndryshon forma e vetës së tretë, numri shumës, koha e pakryer e mënyrës dëftore të foljes zgjedhimit të dytë: në mbaresë bashkëtingëllorja fërkimore alvolare e pazëshme s zëvendësohet me bashkëtingëlloren mbylltore dhëmbore të pazëshme t: 382 *brohoritnin*] *brohorisnin* 31;435 *trokitnin*] *trokisnin* 146;459 *ata e goditnin me thikë,*] *ndërsa ata e godisnin me thikë,* 187;460 *rrëshqitnin*] *rrëshqisnin* 188;464 *po ngjitnin*] *po ngjis-* / *nin* 194 / 195;477 *zvarritnin*] *zvarrisnin* 216

Por edhe: 484 *zgjatnin*] *zgjatnin* 224 dhe pra mbetet e njëjta formë; kemi oscilacion në përdorimin e dy formave.

I njëjti ndryshim pasqyrohet edhe në formën e foljes në kohën e pakryer të mënyrës lidhore: 457 *të zbritnin*] *të zbrisnin* 185

Ndryshon pjesorja e foljes. Ndryshon pjesorja e foljes *kam*:378 *pa e pasur mendjen aty.*] *pa e patur mendjen aty.* 26;466 *pa e pasur mendjen*] *pa e patur mendjen* 197;391 *kishte pasur qejf*] *kish patur qejf* 43;414 *ka pasur*] *ka patur* 96;459 *kishin pasur*] *kishin patur* 187

Ndryshon pjesorja e foljes në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore: 386 *Ai kishte studiuar*] *Ai kish studjuar* 36

Ndryshon pjesorja e foljes në mënyrën përcjellore: 463 *duke zvarritur*] *duke zvarrisur* 193

Ndryshon pjesorja e foljes në paskajore: 481 *për t'i përcjellë.*] *për t'i përcjellur.* 220

Ndryshon numri i foljes: 408 –*Dëgjoni,*] –*Dëgjo,* 430 *E shikon?*] *E shikoni?* 123

Ndryshon veta e foljes: 470 *Ka tetë vjet*] *Kam tetë vjet* 203

2.b. emri

Ndryshon forma e emrit në numrin njëjës:

-Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës të emrit të gjinisë femërore, në numrin njëjës: 363 *dhie*] *dhije* 3; 478 *lëkurë dhie*] *lëkurë dhije* 217; 406 *me një gjest habije.*] *me një gjest habie.* 67; 374 *një farë tronditjeje*] *një farë tronditje* 20; 436 *një qenie*] *një qenje* 148; 452 *qenien*] *qënjen* 179; 436 *nga karrigia*] *nga karrigia* 150; 450 *trashamania,*] *trashamanja* 175;⁶

Ndryshon forma e rasës gjinore të emrit në numrin njëjës: 480 *britma e rojës.*] *britma e rojes.* 219; 480 *nga baraka e rojës*] *nga baraka e rojes* 219; 483 *e rojës,*] *e rojes,* 222

Ndryshon numri i emrit: kalohet nga numri shumës në numrin njëjës: 363 *Nga biseda*] *Nga bisedat* 3; 374 *violina nuk pushonte.*] *violitë nuk pushonin.* 21; 413 *nga altoparlanti,*] *nga altoparlantet,* 92

Kalohet nga numri njëjës në numrin shumës: 399 *buzët*] *buzën* 58; 439 *mbi kokat e njerëzve.*] *mbi kokën e njerëzve.* 160; 408 *në tavolina*] *në tavolinë* 72; 463 *nëpër llapat e veshëve.*] *nëpër llapat e veshit.* 194; 374 *Shumë njerëz zgjatnin kokat*] *Shumë njerëz zgjatnin kokën* 21

Ndryshon forma e shumësit të emrit, kalohet nga një formë jo e normës në një formë të normës

366 *linin gjurmë*] *linin gjurma* 8; 393 *shoferët*] *shoferat* 44; 403 *prapa xhamave.*] *prapa xhameve.* 63; 404 *Përtej kokave*] *Përtej kokëve* 64; 366 *teknografë*] *teknografe* 8; 368 *ca vagonë*] *ca vagona* 10; 436 (2 herë) *me bërryla*] *me bërryle* 150 (2 herë); 456 *Dy rojat,*] *Dy rojet,* 184;⁷

Shohim se mbetet oscilacioni në përdorimin e formës së shumësit të emrit: 394 *Qiparisët*] *Qipariset* 48; 423 *tek ata qiparisët*] *tek ata qiparisat* 115; 366 *me qiparisat*] *me qipariza* 8; 467 *përtej qiparisave.*] *përtej qipariseve,* 199; (por kalohet nga një formë e normës në një formë jo të normës: 457 *me farët e saj të fuqishëm*] *me faret e saj të fuqishme* 185; 476 *e dy farëve*] *e dy fareve* 214); 386 *në të dy filxhanët.*] *në të dy filxhanet.* 37; 390 *Midis vallëzuesve*] *Midis vallëzonjësve* 41; 393 *së vallëzuesve.*] *së vallëzonjësve.* 47; 418 *vallëzuesit*] *vallëzonjësit* 105; 464 *midis vallëzuesve*] *midis vallëzonjësve* 195; 469 *Vite*] *Vjete* 200 - ndryshon forma e shumësit të emrit, kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës; 470 *Ka tetë vjet*] *Kam tetë vjet* 203 - por edhe mbetet e njëjta formë, janë të dyja forma të normës; 471 *lot (të tjerë)*] *lotë* 204

⁶ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

⁷ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

Kemi oscilacion në përdorimin e formave të normës: 392 në *thellësitë*] në *thellësitë* 44; 392 nga *thellësitë*] nga *thellësitë* 44;

- ndryshon trajta e emrit: kalohet nga trajta e shquar e emrit në numrin shumë në trajtën e pashquar të numrit shumë: 383 në *varreza*] në *vorrezat* 33; 393 me *këto fjalime*.] me *këto fjalimet*. 46; 407 me *sy të menduar*.] me *sytë e tij /të menduar*. 70/71; 425 duke u penguar orë e çast nëpër *pellgje*.] duke u penguar orë e çast nëpër *pellgjet*. 118

- ndryshon trajta e emrit në numrin shumë: kalohet nga trajta e pashquar në trajtën e shquar: 457 për dy *katundarët*.] për dy *katundarë*, 185

- ndryshon trajta e emrit në numrin njëjës. Kalohet nga trajta e pashquar në trajtën e shquar: 484 Në *kohën*] Në *kohë* 223

Kalohet nga përdorimi i emrit në gjininë asnjëanëse në gjininë mashkullore: 463 *uji*] *ujët* 194

Ndryshon rasa e emrit: 480 *vështroi një herë rreth e rrotull fushës që nxinte*.] *vështroi një herë rreth e rrotull fushën që nxinte*, 219 - ndryshon rasa e emrit fushë. Kalohet nga rasa kallëzore në rasën rrjedhore.

2.c. mbiemri:

- ndryshon gjinia e mbiemrit në numrin shumë, kalohet nga forma e gjinisë femërore në formën e gjinisë mashkullore dhe kështu kemi përshtajen me gjininë e emrit: 386 *librat e trashë*] *librat e trasha* 36; 387 me *hapa të gjatë e të shkathët*.] me *hapa të gjata e të shkathta*. 38; 417 me *hapa të gjatë*] me *hapa të gjata* 100; 411 me *hapa të mëdhenj*.] me *hapa të mëdha*. 90; 444 më *hapa të shpejtë*.] me *hapa të shpejta*. 165; 394, 453 me *flokë të prerë*] me *flokë të prera* 48, 180; 416 *kilometra të tërë*] *kilometra të tëra* 98

-kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës: 447 me *sy hetues*.] me *sy hetonjës*. 168; 465 *vezulluese*.] *vezullonjëse*, 196; 466 *përvëlues*.] *përvëlonjës* 198; 470 më *kërcënuese*] më *kërcënonjëse* 203; 473 *kërcënuese*.] *kërcënonjëse*, 207

2.d. përemri:

- ndryshon gjinia e përemrit:

477 *mbi ta*.] *mbi to*, 216 - ndryshon gjinia e përemrit vetor, numri shumë, veta e tretë, kalohet nga gjinia femërore në gjininë mashkullore

472 të *gjitha*] të *gjithë* 206 - kalohet nga gjinia mashkullore në gjininë femërore

472 *Ato*] *Ata* 206 - ndryshon gjinia e përemrit vetor numri shumë, veta e treta, kalohet nga gjinia mashkullore në gjininë femërore;

- ndryshon forma e përemrit njëri/njëra dhe njëra-tjetra. Kalohet nga forma jo të normës në format e normës.

367 në *njërën horizont*] në *njerin horizont* 9; Por edhe: 368 nga *njeri kufi i errësirës*] nga *njëri kufi i errësirës* 11; 370 pranë *njërës*] pranë *njerës* 13; 372 me *njërën dorë*] me *njerën dorën* 18;⁸

2.e. trajtat e shkurtra të bashkuara të përemrit vetor:

⁸ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës së trajtës së shkurtër të bashkuar të përemrit vetor: 384 *ia jepnin kafen*] *ja jepnin kafen* 34; 384 *ia jepnin*] *ja jepnin* 34; 384 *Ata ia vranë vëllanë e tretë.*] *Ata ja vranë vëllanë e tretë* 34;386 *ia zgjati.*] *ja zgjati* 37; 387 *ia dha*] *ja dha* 38.⁹

Kemi oshilacion: trajta e shkurtër e bashkuar e përemrit vetor është dhe mbetet ajo e normës:

437 *Rudi iu afrua D. D.*] *Rudi iu afrua përsëri shkrimtarit.* 158; 451 *sytë iu bënë të menduar.*] *sytë iu bënë të menduar.* 177; 464 *Dikush ia kapi njëren dorë.*] *Dikush ia kapi njerën dorë,* 194 (Edhe: 460 *u thoshte vagonëve:*] *i thoshte vagonave:* 189 - ndryshon trajta e shkurtër e përemrit vetor, veta e tretë, numri shumë, rasa dhanore. Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës.)

3. Ndryshimet leksikore

Ndryshimet leksikore janë të shumta. Shpesh kemi të bëjmë me zëvendësimin e një fjale me një fjale sinonime. Për shembull për foljen: 379 *luanin*] *loznin* 28; 388 *luante*] *lozte* 39; 393 *filloi të luante*] *filloi të lozte* 46; 436 *luante*] *lozte* 151; 437 *të luante teatër?*] *të lozte teatër?* 151;475 *luaj rolin*] *loz rolin* 212 (3 *herë*);(Por mbetet folja *loz*: 477 – *Po lozin menç.*] – *Po lozin mënç,* 215);385 *vente e shtrihej*] *vinte e shtrihej* 36;408 *të veja*] *të vija* 72;443 *rrinte*] *vinte* 164; 473 *Zvarritu*] *Vërtitu,* 208; 475 *Ndërsa vallëzonte.*] *Duke kërcyer,* 212; 478 *I ndien?*] *I dëgjon?* 217; 478 - *I ndiej.*] – *I dëgjoj,* 217;386 *duke parë*] *duke vështruar* 37; 399 *tha njëra nga vajzat.*] *e ndërpreu njera nga vajzat shoqen e saj.* 57; 408 *më njohu*] *më prezantoi* 72; 412 *hyri*] *hypi* 90; 412 *pa*] *dalloi* 92; 437 *pëshpëriti*] *tha* 158;

- Për emrin: 377 *me shenja.*] *me gjeste,* 24;389 *Nëpër tryeza*] *NËPËR tavolina* 40;429 *tryezat*] *tavolinat* 122;466 *tryeza*] *tavolina* 197;(Kemi oshilacion: këtu na mbetet e njëjta formë: 429 *në njëren nga tryezat*] *në njerën nga tryezat* 123);434 *në njëren nga tavolinat*] *në njerën nga tavolinat* 144);402 *udhëtarët*] *pasagjerët* 62;;447 *të një dasmori.*] *të një punëtori* 173;462 *njeriu.*] *populli.* 191;464 *një karikaturë miqësore.*] *një fletërrufe.* 195¹⁰

381 *ai i donte shumë ato.*] *ai i donte shumë armët,* 30 - zëvendësohet emri *armët*, me përmrin vetor të vetës së tretë, numri shumë, gjinia femërore *ato*.

456 *u ishte lutur atyre*] *u ishte lutur rojeve* 184 - Përmri vetor zëvendëson emrin në numrin shumë në rasën dhanore

390 *ia bëri tjetri.*] *ja bëri shkrimtari* 41 – emri zëvendësohet nga përmri

412 *Ai*] *Bashkëpunëtori shkencor* 92 - zëvendësohet emri i pasuar nga mbiemri i panyjshëm nga përmri vetor i vetës së tretë, numri njëjës, gjinia mashkullore

435 *Ai*] *shkrimtari* 148 - zëvendësohet emri me përmrin vetor të vetës së tretë numri njëjës, gjinia mashkullore

452 *ai*] *sportisti* 178 - i njëjti ndryshim ndodh edhe këtu.

⁹ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

¹⁰ Japim vetëm një pjesë shumë të vogël të shembujve.

- Për mbiemrin: *[399 zakonore] etnografike 58; 456 me uniformën blu] me uniformën e zezë 184; 475 e agjentit spiun".] e agjentit grek." 212; 420 e sakta.] ekzakte. 108*

4. Ndryshimet sintaksore & shenjat e pikësimit

Japim vetëm disa periudha ku autori ndryshon shenjat e pikësimit në lidhje me strukturën sintaksore.

370 *Sidoqoftë, dasma kishte filluar pa ata, dhe ai boshllëku i lehtë që krijonte gjithë mbasditen mungesa e tyre, tani po mbushej nga muzika, nga këngët dhe nga rrëmuja e gëzuar.] Sidoqoftë, dasma kishte filluar pa ata, dhe ai boshllëku i lehtë, që krijonte gjithë mbasditen mungesa e tyre, tani po mbushej nga muzika, nga këngët dhe nga rrëmuja e gëzuar.*

- eliminohet presja në fillim të fjalisë së varur përcaktore dalluese dhe kështu respektohet norma.

377 – *Çfarë the, Rudi, - pyeti një vajzë me flokë gështenjë, që u gjend rastësisht përbri shkrimtarit.] – Çfarë the, Rudi, - pyeti një vajzë me flokë gështenjë që u gjend rastësisht përbri shkrimtarit. 25*

- shtohet presja para fillimit të fjalisë së varur përcaktore përshkruese dhe kështu respektohet norma.

378 *Ishte po ajo vajzë që e kishte vështuar disa herë me një shikim të gëzuar dhe të habitur njëkohësisht.] Ishte po ajo vajzë, që e kishte vështuar disa herë me një shikim të gëzuar dhe të habitur njëkohësisht. 26*

- eliminohet presja para fillimit të fjalisë së varur përcaktore dalluese dhe kështu respektohet norma.

384 *Malësorët e tjerë, që në atë kohë ndodheshin nëpër pragjet e kullave, ngriheshin në këmbë me respekt, kur përpara tyre kalonin gratë me qetë.] Malësorët e tjerë, që në atë kohë ndodheshin nëpër pragjet e kullave, ngriheshin në këmbë me respekt kur përpara tyre kalonin gratë me qetë. 34*

- shtohet presja para fillimit të fjalisë së varur kohore dhe kështu respektohet norma.

Nga shembujt që kemi gjetur me vjeljen e materialit na rezulton se autori, përveç ndërhyrjeve në strukturën e veprës (eliminimet e shumta, ndryshimi i paraqitjes së kapitujve, meqë atyre u hiqet titulli dhe pajisen me numër, ndryshimin i emrit të njërit prej personazheve kryesore) kryen shumë ndryshime edhe në gjuhën që përdor në tekst. Variantet e autorit që kemi gjetur na dëshmojnë respektimin e normave të gjuhës letrare të vendosur në Kongresin e Drejtshkrimit në *Lëkurën e daulles* të botuar në vitin 1980 në fonetikë, morfologji, leksik. Për sintaksën variantet e autorit janë të lidhura ngushtë me shenjat e pikësimit të fjalisë e të periudhës. Edhe pse eliminimet e kanë ulur gjatësinë e tekstit, edhe pse ky roman, padrejtësisht, është lënë mënjanë dhe anatemuar edhe nga vetë autori, vlera dhe vendi i tij në strukturën e sistemit letrar të Kadaresë janë të një rëndësie të veçantë. Autori e ka përpunuar gjuhën edhe në këtë tekst si edhe në veprat e tjera të tij. Variantet e autorit janë prova të pakundërshtueshme të gjuhës dhe të stilit të tij sidomos në kalimin në dy botimet që kemi shqyrtuar në këtë punim.

